



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBËR**

**NJESIA E PROKURIMIT**

**Dibër, më 31.10.2024**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** Sistemim Asfaltim e rrugeve te brendeshme te fshatit Greve ,  
Njesia Administrative Melan , Bashki Diber

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Pune ndertimi  
(45000000-7).

**VLERA E FONDIT LIMIT: 8.333.333 ( Tete milion e treqind e tridhjete e tremije e treqind e  
tridhjete e tre leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe  
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit  
publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Diber ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe  
miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me  
përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2021,2022,2023**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika “c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë të percaktuara në aktmarreveshje.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

**2.2.2.** Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2021,2022,2023**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës ose lotit që prokurrohet.

*Kjo pikë konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

---

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitet 2024 prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

*Shenim:* Per kete pike 2.2.3 te mesiperme operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

*ose*

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

## **Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

### **Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:**

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
  1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
  2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
  3. Situacionin përfundimtar të objektit;
  4. Aktin e kolaudimit;
  5. Çertifikaten e marrjes në dorëzim;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
  1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me:
  2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
  3. Situacionin përfundimtar të objektit;
  4. Aktin e kolaudimit;
  5. Fatura tatimore të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

*Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*

*Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

---

### 2.3.2 Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për këto punime.

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- |                                   |         |
|-----------------------------------|---------|
| 1. Inxhinier Ndertimi             | 1 (nje) |
| 2. Inxhinier Topograf ose Gjeodet | 1 (nje) |
| 3. Inxhinier hidroteknik          | 1 (nje) |

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën periudhën **Gusht 2024 e në Vazhdim**. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune noteriaale (e vlefshme).

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij personel të kualifikuar/certifikuar si:

- 1 (një) punonjes përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, i cili të jetë i certifikuar “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

*Shenim:* Për këten pikë 2.3.2 a) dhe b) të mesipërme operatorët ekonomik në fazën e ofertimit duhet të paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punetore të shtuar dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kesaj kontrate.

**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej mesatarisht **25 (njetzet e pese) punonjës.**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **gusht 2024– e ne vazhdim.**
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **gusht 2024– e ne vazhdim.**

*Shenim: Per kete pike 2.3.3 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.*

*Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, te pakten si me poshte:

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **2 (dy)** punonjes **manovratore** te, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme), leshuar nga institucionet perkatese, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme) , si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise per të pakten muajin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **2 (dy)** punonjes **shofer** te mjeteve te renda, per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme), deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme),leshuar nga institucionet perkatese, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise per të pakten muajin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1 (nje)** teknik ndertimi , per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, diplome,

deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme), si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise për të pakten periudhën si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise për të pakten muajin e fundit.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1 (nje)** saldator, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmi e aftesise profesionale, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme), si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise për të pakten muajin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **2 (dy)** betonues, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmi e aftesise profesionale, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme), si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise për të pakten muajin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1 (nje)** karpentier, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmi e aftesise profesionale, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme), si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise për të pakten muajin e fundit.

*Shenim:* Per kete pike 2.3.4 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

*Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

### **2.3.5 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.**

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmoje se dispononë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit,

*klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.*

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

## **PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**

N.P-1 A (Punime gjurmimi në tokë)

N.P-4 B (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)

N.P – 5 A ( Punime nëntokësore, ura e vepra arti)

N.P - 7 A (Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje).

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme.

N.S -6 A (Sinjalistika rrugore jo ndricuese).

N.S – 18 A (Punime topogjeodezike).

N.S-1 A (punime prishje te ndertimeve)

- **sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;**

*Për operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njëhësimin*) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkëngjitur në SPE.

**2.3.6** Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- SSH/EN/ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) ose ekuivalent;
- SSH/EN/ ISO 45001-2018 mbi “Sistemin e menaxhimit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalent;
- SSH/EN/ISO 39001 :2012 mbi “Sistemi i Menaxhimit të Trafikut Rrugor” ose ekuivalent;
- EN ISO 3834-2:2006 “Sistemi kualifikimi për produktet e salduara” ose ekuivalent;



*Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.7** Operoret ekonomik duhet te paraqesin mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (shtojces 8):

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamiona vetshkarkues kap. mbajtes mbi 8 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
2	Kamioncina me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
3	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Rrul ngjeshes	Në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Fabrike asfalti-betoni e pajisur me leje mjedisore	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi	Copë 1
7	Nyje thyerje materiale inerte e pajisur me leje mjedisore	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi	Cope1
8	Eskavator me zinxhir	Ne pronesi ose me qera	Cope1
9	Armature	Ne pronesi ose me qera	100m2
10	Autobitumatriçe	Ne pronesi ose me qera	Cope 1
11	Asfalto-shtrues	Ne pronesi ose me qera	Cope 1
12	Fadrome me goma	Ne pronesi ose me qera	Cope 1
13	Makineri vijezimi	Ne pronesi ose me qera	Cope 1
15	Matrapik	Ne pronesi ose me qera	Cope 1
16	Saldatriçe	Ne pronesi ose me qera	Cope 1
17	Gjenerator	Ne pronesi ose me qera	Cope 1

18	Vibrator	Ne pronesi ose me qera	Cope 1
----	----------	------------------------	--------

***Operatorët ekonomik që disponojnë kontratë furnizimi për Fabrikat asfalti-betoni e pajisur dhe Një thyerje materiale inerte, leja mjedisore u kërkojnë personave të tretë, që nuk janë konkurrent në këtë procedurë prokurimi.***

Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesi ose me qera), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

- Kokore, minimumi 25 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë.
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi, 3 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 5 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 5 copë
- Për makineri teknologjike dhe mjete që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: çertifikatë pronësie, leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, siguracionin;
- Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- Për makineri teknologjike dhe mjete që nuk shënohen në regjistra publikë (makineritë teknologjike), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.
- Ndërsa për makineri teknologjike dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimi ose faturë tatimore blerje) dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- Për pajisjet kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontratë blerje/faturë zhdoganimi/faturë tatimore blerje.
- Ndërsa për pajisjet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimi/faturë tatimore blerje) e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.
- Për makineritë teknologjike dhe mjetet, fotoja duhet të ketë të dallueshme edhe targën e mjetit.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues.
- Për Fabrikat e prodhimit të betonit /inerteve OE duhet të paraqesin kontratë furnizimi (Kontrata Noteriale e Qerasë/Furnizimit)

- Mjeti autobitumatriçe te shoqerohet me Leje te Transportit te Mallrave te rezikshme(te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

*Shenim: Per kete pike 2.3.7 te mesiperme operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.*

*Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialisti i fushës.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licensë III.2.B për "Grumbullim, dhe transportim i mbetjeve inerte dhe urbane jo të rrezikshme".

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", për realizimin e punimeve sipas zerave të preventivit konkretisg zerat: 3.158/1a dhe 3.258/5a.

### **2.3.9. Grafiku i punimeve.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike jane hartuar nga projektuesi, bashkengjitur DST ne SPE.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

**Njesia e prokurimit:**

**Leonard Topuzi**

**Edvin Shahi**

**Ejona Noka**